



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.52 Prot.

Tiranë, më 10/01/ 2022

### V E N D I M

**Nr. 10, Datë 10 /01/ 2022**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr.230 regj, datë 07.12.2021, paraqitur nga ankuesi A.Ç, kundër Ministrisë së Mbrojtjes, në të cilën pretendon diskriminim në kuadër të termit “*për çdo shkak tjetër*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi A.Ç parashtron se është dënuar politikisht në vitin 1989 dhe ky fakt është pranuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Kryeministria. Për dënimin në mënyrë të padrejtë ka kërkuar riveshjen officer aktiv, në bazë të nenit 1, të Dekretit të Kuvendit Shqiptar nr.7541, datë 30.09.1991, por padrejtësisht është bërë officer rezervë. Ankuesi shpjegon se ka kërkuar në vazhdimësi të drejtën e tij dhe në datën 15.10.1997, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr.2799, ankuesi është rritulluar officer aktiv dhe është emëruar Komandant batalioni Gërhoh, Gjirokastër. Ankuesi informon se ky urdhër nuk i është komunikuar dhe është mbajtur sekret për 12 vjet.

Gjatë periudhës 1997-2009, ankuesi shpjegon se i është drejtuar disa institucioneve si Ministria e Mbrojtjes, Kryeministri, për ta riveshur officer aktiv, urdhër i cili kishte dalë por mbahej sekret, ankuesit i është komunikuar më datë 03.11.2009. Sipas ankuesit, institucionet kanë ngritur pretendime se ai nuk kishte pranuar, nuk është paraqitur apo se kishte qenë jashtë shtetit në Greqi,

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

por këto pretendime hidhen poshtë nga përgjigja e Avokatit të Popullit datë 13.09.2013, ku sqarohet se ankuesi nuk ishte lajmëruar për urdhrin e datës 15.10.1997.

Pasi ka marrë këtë përgjigje nga Avokati i Popullit, ankuesi shprehet se ka kërkuar që urdhri nr. 2799, datë 15.10.1997 të rivlerësohej, duke iu drejtuar për këtë arsye, ish Ministres së Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli dhe z. Edi Rama, Kryeministër. Në vijim, ankuesit i është komunikuar urdhri nr.102, datë 20.01.2015, jo në formën origjinale, por fotokopje e aktit. Ankuesi shprehet se ka kërkuar kopjen origjinale të këtij urdhri, por nuk i është vendosur në dispozicion. Në datën 06.04.2017 ka marrë një përgjigje nga Ministria e Mbrojtjes, të cilën ankuesi e konsideron si tallje, cinizëm dhe diskriminim. Në vijim ankuesi deklaroi se në datë 10.04.2018, i ka dërguar një shkresë Kryeministrit në lidhje me përgjigjen e mësipërme të dërguar nga Ministria e Mbrojtjes, por nuk mori asnjëherë përgjigje.

Ankuesi deklaroi se për problemin e tij i është drejtuar Avokatit të Popullit, i cili më datë 16.03.2021, i ka kthyer përgjigje duke e informuar se, bazuar në vendimin e gjykatës, Ministria e Mbrojtjes ka nxjerrë urdhrin nr.102, datë 20.01.2015 *“Për deklarin e pavlefshmërisë absolute të urdhrin nr.2799, datë 15.10.1997, të Ministrit të Mbrojtjes”*. Sipas ankuesit, referuar vendimit të gjykatës, urdhri nr.2799, i cili u mbajt sekret për 12 vjet, nuk iu dha gjykatës kur u kërkua nga Avokati i Popullit, por 3 muaj më vonë, kur u mbyll procesi gjyqësor. Ankuesi thekson se, ai ka qenë në dispozicion të Ministrisë së Mbrojtjes dhe është paraqitur si punëkërkues. Në vijim, ankuesi shprehet se për këtë padrejtësi i është drejtuar sërish Kryeministrit më datë 09.09.2021 por nuk ka marrë përgjigje.

Në bazë të viteve të punës si oficer aktiv dhe përgjigjeve të Ministrisë së Mbrojtjes datë 07.11.2012 dhe 21.03.2013, ankuesi shprehet se ka dorëzuar dy herë dokumentacionin për të përfituar pension të parakohshëm dhe në dallim nga të gjithë shokët, nuk e ka marrë pensionin. Ankuesi pretendon se ai është duke u persekutuar politikisht, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes.

- Me shkresën nr. 1617/2 prot., datë 20.12.2021, janë administruar parashtrime shtesë në lidhje me ankesën, të paraqitura nga Avokat Adem Ajdini, pwrfaqwsues me prokurw i ankuesit, i pajisur me prokurwn e posaçme nr.7756 rep dhe nr.840 kol datë 05.11.2021. Ndër të tjera, pala ankuese, kërkon nga Komisioneri:

1. Hetimin administrativ mbi diskriminim e z. A.Ç, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes,
2. Konstatimin e diskriminimit për shkeljen e të drejtës për vjetërsi shërbimi në forcat e armatosura nga momenti i ndërprerjes së karrierës me urdhrin e padrejtë nr.2079/1, datë 12.07.1989 të Ministrit të Mbrojtjes e deri në momentin e rititullimit oficer aktiv me aktin/urdhër nr.2799, datë 15.10.1997, të Ministrit të Mbrojtjes.
3. Konstatimin e diskriminimit në shkeljen e të drejtës së punësimit në forcat e armatosura nga momenti i ndërprerjes së karrierës me urdhrin e padrejtë nr.2079/1, datë 12.07.1989 të Ministrit të Mbrojtjes e deri në momentin e rititullimit oficer aktiv me aktin/urdhër nr.2799, datë 15.10.1997 të Ministrit të Mbrojtjes.

4. Konstatimin e diskriminimit në shkeljen e të drejtës së fituar me urdhrin nr.2799, datë 15.10.1997, të Ministrit të Mbrojtjes, për rritullimin oficer aktiv, me gradën kapiten i parë dhe detyrën e komandantit të batalionit të dytë të këmbëtorisë Gerhot/Gjirokastrë.
5. Konstatimin e diskriminimit në nxjerrjen e aktit diskriminues, urdhri nr.102, datë 20.01.2015 të Ministrit të Mbrojtjes “Për deklarimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr.2799, datë 15.10.1997 të Ministrit të Mbrojtjes “Për rritullimin e oficerit aktiv A.Ç me gradën kapiten i parë dhe detyrën e komandantit të batalionit të dytë të këmbëtorisë Gerhot”
6. Konstatimin e diskriminimit për mosdhënien e pensionit të parakohshëm të ushtarakut nga momenti i lindjes të së drejtës më 21.09.1998 në moshën 47 vjeç e deri më 21.09.2016, në moshën e daljes në pension pleqërie 65 vjeç.

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Bazuar në faktet dhe kërkimet e parashtruara nga ankuesi, dokumentacionin e depozituar si dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gërmat “d” e “dh”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ku parashikohet se : “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”. Komisioneri vlerëson se ankesa objekt shqyrtimi nuk duhet të pranohet për arsyet e mëposhtme.

Së pari: Rezulton se, për diskriminimin e pretenduar nga ankuesi lidhur me, shkeljen e të drejtës për vjetërsi shërbimi dhe të drejtës së punësimit në forcat e armatosura, nga momenti i ndërprerjes së karrierës me urdhrin e padrejtë nr.2079/1, datë 12.07.1989 të Ministrit të Mbrojtjes e deri në momentin e rritullimit oficer aktiv me aktin/urdhër nr.2799, datë 15.10.1997, të Ministrit të Mbrojtjes, të gjitha faktet që lidhen me këto pretendime kanë ndodhur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, e për rrjedhojë këto pretendime për diskriminim nuk mund të merren në shqyrtim nga Komisioneri, si pasojë e ndalimit ligjor të vendosur nga neni 33, pika 4, germa “d”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Së dyti: Në lidhje me pretendimin e ankuesit, për konstatimin e diskriminimit në shkeljen e të drejtës së fituar me urdhrin nr.2799, datë 15.10.1997, të Ministrit të Mbrojtjes, për rritullimin oficer aktiv, me gradën kapiten i parë dhe detyrën e komandantit të batalionit të dytë të

këmbësoresë Gerhot/Gjirokastër, Komisioneri vlerëson se edhe ky pretendim i ankuesit, nuk mund të merret në shqyrtim, pasi të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e këtij kërkitimi, kanë ndodhur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Sipas shpjegimeve që ankuesi ka dhënë në ankesë, diskriminimi në lidhje me këtë moment lidhet me mosinformimin dhe mosekzekutimin e këtij urdhri. Rezulton se urdhri për rritullimin oficer aktiv të ankuesit ka datë në 15.10.1997, pra në thelb, e drejta që ankuesi pretendon se i është cënuar, ka lindur me daljen e këtij urdhri, pra kemi të bëjmë me fakte të cilat kanë ndodhur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.10221/2010. Komisioneri konstaton gjithashtu se, ka një korrespondencë të gjatë të ankuesit me disa institucione si Ministria e Mbrojtjes, Kryeministri, Avokati i Popullit, në lidhje me këtë problematikë. Ankuesi rezulton se ka hapur edhe një proces gjyqësor në lidhje me kërkimin e të drejtave që i burojnë nga dalja e urdhrit nr.2799, datë 15.10.1997, proces i cili nuk është finalizuar me zgjidhjen në themel të pretendimeve të paditësit, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.5198 datë 15.09.2009, ka vendosur kthimin e kërkesë padisë për shkak të të metave, pasi ankuesi nuk kishte depozituar aktin e kundërshtuar. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 98, datë 02.04.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Ankuesi pretendon se është pajisur me një kopje të urdhrit të sipërcituar vetëm në datën 03.11.2009. Edhe në këtë situatë, Komisioneri konstaton se kemi të bëjmë me ngjarje dhe fakte që kanë ndodhur përpara hyrjes në fuqi të ligjit.

Komisioneri thekson gjithashtu se, urdhri nr.2799, datë 15.10.1997, i Ministrit të Mbrojtjes është deklaruar absolutisht i pavlefshëm me urdhrin nr.102, datë 20.01.2015, të Ministrit të Mbrojtjes dhe ky i fundit është aktualisht në fuqi, pasi nuk rezulton që të jetë shfuqizuar, anuluar apo konstatuar si absolutisht i pavlefshëm.

Së treti: Në lidhje me pretendimin për diskriminim në nxjerrjen e urdhrit nr.102, datë 20.01.2015 të Ministrit të Mbrojtjes “Për deklarimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr.2799, datë 15.10.1997 të Ministrit të Mbrojtjes “Për rritullimin e oficerit aktiv A. Ç me gradën kapiten i parë dhe detyrën e komandantit të batalionit të dytë të këmbësoresë Gerhot, Komisioneri konstaton se këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim, pasi ankesa është paraqitur më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit të pretenduar. Sjellja diskriminuese e pretenduar nga ankuesi ka ndodhur me miratimin e urdhrit nr.102, datë 20.01.2015 dhe ankesa pranë Komisionerit është paraqitur në datën 07.12.2021.

Së katërti: Në lidhje me pretendimin e ankuesit për konstatimin e diskriminimit për mosdhënien e pensionit të parakohshëm të ushtarakut nga momenti i lindjes të së drejtës më 21.09.1998 në moshën 47 vjeç e deri më 21.09.2016, në moshën e daljes në pension pleqërie 65 vjeç, Komisioneri konstaton se, faktet që përbëjnë thelbin e këtij pretendimi të parashtruar në ankesë kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Pretendimi i ankuesit për të përfituar pensionin e parakohshëm si ushtarak, është ngushtësisht i lidhur me kërkimet e tjera të parashtruara nga ankuesi, sikurse pretendimi për cënimin e të drejtës për vjetërsi shërbimi për kohën e ndërprerjes së karrierës për shkak të urdhrit nr.2079/1 datë 12.07.1989, të Ministrit të Mbrojtjes, deri në momentin e urdhrit nr.2799 datë

15.10.1997. Pra baza e pretendimit të ankuesit për mospërfitimin e pensionit të parakohshëm të ushtarakut, lidhet me fakte dhe ngjarje që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të ligjit, sikurse është urdhri nr.2079/1 datë 12.07.1989, të Ministrit të Mbrojtjes.

Së pesti: Komisioneri vlerëson se, fakti që ankuesi ka kërkuar në vazhdimësi të drejtën e tij, nuk e rivendos atë në afat për të paraqitur ankesën pranë Komisionerit, sipas parashikimeve të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, si dhe bazuar në arsyetimin e mësipërm, Komisioneri arrin në përfundimin se, nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërmat “d”, “dh”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe për rrjedhojë ankesa e paraqitur nga ankuesi A.Ç nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të shqyrtimit.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32, pika 1/a, nenin 33, pika 4, gërma “d”, “dh” dhe nenin 33 pika 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 230 regj., datë 07.12.2021, të paraqitur nga ankuesi A.Ç.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijani, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Shkaku: “për çdo shkak tjetër”  
Lloji i vendimit: Mospranim